Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gani Nekaj	**11.12.2023**	**19.12.2023**	**2023/0988**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 07.12.2023, OE "Gezime S. Gashi B.I."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0988, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE **"WOOD COMPANY SHPK**."- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pelet per ngrohje per nevojat e shkollave" me nr. të prokurimit: "97500-23-10715-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 119,700.00 €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0988 i dt: 07.12.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Data e njoftimit për kontratë: 05.10.2023

Afati për dorëzimin e ofertave: 31.10.2023

Procesverbali i hapjes se ofertave : 31.10.2023

Njoftimi mbi Vendimin e AK-se dhe Letrat Standarde-23.11.2023

Kërkesa për Rishqyrtim nga OE **ankues**: 27.11.2023

Vendimi ndaj Kërkeses per Rishqyrtim : 30.11.2023

Ankesa ne OSHP nga OE **ankues**07.12.2023

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimet Ankimore te Operatorit Ekonomik janë:

- Sipas operatorit ekonomik dispozitat e shkelura te Ligji për Prokurim Publik Nr. 04/L-042 nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë vlerësimit te ofetave janë:

- Neni 1 Qëllimi i LPP-së

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP-së;

- Neni 27 Dosja e Tenderit i LPP-së;

- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

- Neni 68 Gjendja ekonomike dhe financiare i LPP-së;

- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë; dhe

- Neni 8 i Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik.

Deklaratë mbi Faktet dhe Argumentet

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rriturve gjatë procesit të vlerësimit i ka dërguar kërkesë për sqarime OE dhe ka kërkuar sqarime lidhur përmbuushjen e kriterit për qarkullim në shumën 200,000 €.

Ne i kemi ofruar përvec Deklarates Vjetore tatimore në ATK edhe raportin e skanuar dhe të vulosur të nënshkruar nga banka si dhe I kemi dhënë sqarimet tona se Deklarata vjetore tatimore e përmbanë qarkullimin vjetor pa TVSH për arsye të kërkesave ligjore të saj. Si dëshmi tëdokumentuar së RRON 2019 e përmbush qarkullimin e kemi dorëzuar edhe raportin e bankës.

Kronologji e aktivitetit të prokurimit

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar gjithsejtë 9 operatorë ekonomik. Nga procesi i vlerësimit ishte rekomanduar për kontratë WOOD COMPANY SHPK" me çmim

prej 67,200.00 € me cmim me të lartë se ne OE RRON 2019 që kemi ofertuar më cmim më të lirë.

Neve na ishte dërguar letra standarde për sqarimin e tenderit dhe ne ju kemi përgjigjur duke ofruar dëshmi të dokumentuara.

Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rriturve nuk i ka respektuar dispozitat e LPP dhe legjislacionit sekondar lidhur me kriteret për gjendjen ekonomike dhe financiare, rrjedhimisht sipas Udhëzues Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, nenit 8.5 Kriteret e Përzgjedhjes, kërkesat minimale për kualifikim, gjendja ekonomike dhe financiare mundë të plotësohet nga këto dëshmi:

a. Deklaratë adekuate ose deklarata nga një ose më shumë banka; ose

b. Dëshmi të policës relevante të sigurimit të lëshuar nga një kompani e licencuar dhe me

reputacion; ose

c. Kopje të certifikuara të një ose më shumë pasqyrave të bilancit ose pjesë të pasqyrës së bilancit;

ose

d. Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur

e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose

e. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës. OE RRON 2019 i ka prezantuar i ka prezantuar Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në ATK me shumën 175,484.27 € dhe e ka informuar AK Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rriturve se ky qarkullim në ATK është pa TVSH, kjo për faktin se në ATK nuk prezantohet qarkullimi me TVSH. Për ta siguruar AK se qarkullimi i OE RRON 2019 është më i lartë se vlera e kërkuar e qarkullimit në përgjigje të sqarimeve të kërkuara, ia ka përcjell qarkullimin bankar që dëshmon se OE RRON 2019 i përbush kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet për ngrohje për nevojat e shkollave" me Nr. Prokurimit 97500-23-10715-1-2-1.

Mos marrja për bazë e dëshmive të bankes së OE RRON 2019 e tejkalon qarkullimin e kërkuar nga AK Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rriturve është shkelje e dipozitave të ligjit për prokurim publik dhe legjislacionit sekondar si dhe e demton buxhetin e AK duke ju dhene oferta OE me cmim me te larte.

Po ashtu, mosmarrja në shqyrtim e raportit të bankës me të cilën dëshmohet se kemi qarkullim për ta përmbushur kriterin e kërkuar në dosjen e tenderit është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, neni 8.5, pika ii "Shënim për kërkesat e gjendjes ekonomike dhe financiare (neni 68 i LPP-se), e cila thotë "Qëllimi i këtij kriteri është që të vlerësojë nëse tenderuesi ka

stabilitetin e mjaftueshëm financiar dhe ekonomik për të përformuar kontratën e propozuar.

Në përgjithësi, Operatorëve ekonomik u lejohet të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim:

a. Raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka;

b. Evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve;

c. Kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohetpublikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të Operatorit ekonomik

d. Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollimapo një auditor i licencuar i pavarur; ose

e. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës ose nga vendi I themelimit.

Mos marrja për bazë e të vërtetës se qarkullimi i ofruar nga OE RRON 2019 sipas raporteve të bankës është mbi 200,000 € dhe se në ATK raportimi i qarkullimit bëhet neto pra pa TVSH, cilësohet edhe si shkelje e rëndë e Zyrtarit të Prokurimit bazuar në nenin 97, paragrafi 1 sepse është shkelje e parimeve themelore përfshijnë, vendosjen e kritereve apo dëshmive jo në përputhje me LPP, trajtim jo të barabart të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, dhe sjellje jo profesionale e zyrtari të prokurimit ndaj operatori ekonomik RRON 2019.

Gjithashtu, veprimi i mos trajtimit të qarkullimit sipas LPP, legjislacionit sekondar dhe ligjeve të ATK konsiderohet si tendenc për eliminim nga konkurrenca për bizneset e vogla dhe të mesme.

Ne konsiderojmë së mospërfillja e dëshmive të lejuara me LPP dhe legjislacionin sekondar për ta dëshmuar qarkullimin të cilin e përbushim sipas kërkesave të AK dëmton qëllimin e këtij kriteri dhe paranë publike.

Prandaj kërkojm nga OSHP që të marr sqarime nga ATK dhe banka lidhur me plotësimin e kriterit për qarkullim nga OE RRON 2019 dhe lenden ta kthej ne rivleresim.

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë, konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse ne i kemi plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe jemi OE më cmim më të lirë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse ne jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Gjatë zhvillimit të kësaj procedure nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë që të nxjerrët:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE RRON 2019

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në

RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Ne vijim janë paraqitur kriteret e vlerësimit vetëm ato qe kanë te bëjnë me pretendimet ankomore.

Kërkesat; Kapaciteti ekonomiko financiar

- **Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) gjatë tri viteve (2020, 2021, 2022) kanë qenë në shumë jo me pak se 200,000.00 €. Në rast të pjesëmarrjes së Grupit të OE, Lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të këtijë qarkullimi.**

Dëshmija e Kërkuar

- **Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës ose nga vendi i origjinës.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e rivlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni i vlerësimit në bazë vlerësimit dhe krahasimin të ofertave, ka konstatuar se për tenderin "Furnizim me pelet për ngrohje për nevojat e shkollave", janë pranuar 9 oferta-tender dhe ne baze te dokumentacionit te prezantuar 6 (gjashtë) tenderues (2, 3, 4, 6, 8 dhe 9, nga procesverbali i hapjes) janë të përgjegjshëm, kurse 3 (tre) tenderues (1, 5 dhe 7) janë të papërgjegjshëm.

Duke e marrë parasysh se kriter vlerësim ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimi më i ulët, komisioni vlerësues u përcaktua që të pranohet oferta e tenderuesit "WOOD COMPANY" SH.P.K., Lagjia Vitija, Marec, Prishtine, i cili ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët në shumë prej 67,200.00 €, prandej Komisioni i vlerësimit i rekomandon Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit që këtë kompani ta shpërblejë me kontratë.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Ne mbështetje te nenit 4.1.26 konstatojmë se OE ankues"- ne cilësinë e operatorit ekonomik ankues është palë me interes.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Gëzime S. Gashi B.I.**

Përgjigje në pretendimi nr.1

Permes këtij pretendimi operatori ekonomik ankues pretendon se AK-AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR, ka shkelur kritret e perzgjeshjes sipas kërkesave të parapra ne dosje te tenderit saktësisht tek Kapaciteti ekonomiko financiar.

Ne dosje te tenderit si kërkesë tek kapaciteti ekonomiko /financuar ka qenë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) gjatë tri viteve (2020, 2021, 2022) kanë qenë në shumë jo me pak se 200,000.00 €. Në rast të pjesëmarrjes së Grupit të OE, Lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të këtijë qarkullimi.

Ndërsa dëshmia e kërkuar ka qenë:

Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës ose nga vendi i origjinës.

Operatori Ekonomik ankues ka dorëzuar deklaratën e ATK-së si dëshmi qarkullimi per vitin 2022 ku qarkullimi sipas kësaj deklarate arrin vlerën prej 175,484.27€.

AK- AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR, gjatë fazës se vleresimit ka kërkuar sqarime shtesë sipas neit 59 dhe 72 te LPP-se tek Operatori ekonomik ankues OE "Gëzime S. Gashi B.I.", dhe me dt. 06.11.2023 ooperatori ekonomik ankues ka kthyer sqarimet tek Autoriteti Kontraktues , si në vijim:

Të nderuar/a,

Në përgjigje të kërkesës tuaj, të bashkangjitur në e-prokurim i gjeni këto dokumente shtesë:

- PD- Formulari i Deklarimit Vjetor dhe Pageses për Tatim në të Ardhurat Personale, në të cilin të ardhura bruto për vitin 2022 janë 175,484.27 €. Për sqarim vlera 175,484.27 € është vlera pa TVSH bazuar në rregullat e ATK. Vlera totale e qarkullimit për vitin 2022 për OE Gëzime S. Gashi ka qenë 207,071.44 € dhe për ta konfirmuar këtë qarkullim të realizuar të bashkangjitur e gjeni qarkullimin bankar për vitin 2022 të konfirmuar nga banka në të cilën e ka llogarin OE Gëzime S. Gashi.
- OE Gëzime S. Gashi nuk ka qarkullim në vitin 2020 dhe 2021;
- Kontratat dhe referencat e bashkangjitura gjithashtu e konfirmojnë qarkullimin e cekur më lartë.

Nga përshkrimi i mësipërme rezulton se Operatori Ekonomik ankues përmes dëshmisë se ofruar nuk ka përmbushur totalin e qarkullimit te kërkuar nga Autoriteti Kontraktues përmes dëshmisë se ATK-së**.**

Kërkesa dhe Dëshmija e kërkuar nga Autorteti Kontraktues në dosje te tenderit ka qenë e çart se duhet te plotësohet kriteri i qarkullimit ne 3 vite (2020, 2021 dhe 2023) ne shumën jo me pak se 200.000.00€ dhe duhet te dëshmohet me deklaratën vjetore te dorëzuar ne Admnistraten Tatimore te Kosovës.

Në ketë menyrë operatori ekonomik ankues nuk ka përmbushur kërriterin e përzgjedhjes tek kërkesat ekonomiko/financiare dhe nuk është në harmoni me nenin 59 pika 4, citat neni:

"Autoriteti kontraktues dotëkonsiderojënjëtendersi tëpërgjegjshëmvetëmnësetenderinë fjalëështë nëpërputhshmërimetëgjithakërkesateparashtruaranë njoftimine kontratësdhenë dosjenetenderit".

Bazuar ne sqarimet lartekura, kërkesat e dosjes se tenderit, ofertën e operatorit ekonomik ankues, sqarimet shtesë, dhe te gjitha shkresat e lëndës konstatojmë se pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i pabazuar.

Eksperti shqyrtues rekomandon panellin shqyrtues qe ankesa e operatorit ekonomik te refuzohet si e pa

bazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-së i datës 23.11.2023.

Sqarim:

Raporti i ekspertit nuk paragjykon ecurin e metejme te aktivitetit te prokurimit nëse per te njëjtin aktivitet te prokurimit kemi edhe ankesa tjera te cilat mund te ndryshojn ecurin e aktivitetit te prokurimit.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues:

- **Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues "Gëzime S. Gashi B.I" është e pa BAZUAR,**

- **Të mbetet ne fuqi NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK-së i datës 23.11.2023**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Gëzime S. Gashi B.I.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
PANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Gani Nekaj